

Dr. Feti Mehdiu- Prishtinë
Fakulteti i Filologjisë

POEZI ARABE NGA SIRIA DHE SUDANI TË PËRKTHYERA NË GJUHËN SHQIPE

8.0 Poezi arabe nga Siria *

8.1. Dr.Ahmed Sulejman Al-Ahmed (1926)

Poet, kritik letrarë, doktor shkencash në filozofi dhe sociologji, profesor i letërsisë arabe në Universitetin e Damaskut¹, është autor i disa përmbledhjeve me poezi dhe autor i disa veprave me kritikë letrare. Me gjithë veprat e përkthyer ai ka 27 vepra të botuara.² Në vitin 1976 botoi librin me tregime për fëmijë nga letërsia bullgare.

A.S. al-Ahmed në gjuhën shqipe, për herë të parë, është prezentuar me poezitë: *Dashuria dhe Marramenti (fragment)*. Ky përkthim është botuar në Rilindje, në vitin 1979, por nuk jepet shenimi se kush i përktheu.³ Megjithatë kemi konstatuar se këto poezi i përktheu nga gjuha arabe M. Mufaku. Në shenimet që jepen, me këtë rast, për autorin thuhet se ka botuar “ mëse 200 vepra në poezi, dramë, kritikë e studime”. Me siguri këtu fjala është për punime dhe artikuj të ndryshëm, sepse në shenimet bibliografike që i gjejmë në librin e botuar në Damask në vitin 1984 nga Lidhja e Shkrimtarëve arabë, nuk i hasim këto shënime.⁴

• Pjesë nga disertacioni i doktoratës: **Përkthimet e letërsisë arabe në gjuhën shqipe 1922-1982**, të mbrojtur në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë, në vitin 1990. Edhe më parë janë botuar pjesë nga kapitulli për poezinë. Shih: *Përkthimet e poezisë së re arabe në gjuhën shqipe - Algjeria, Gj. Albanologjike, nr.27,1997 (seria e shkencave filologjike) Prishtinë; ... Iraku, Filologji,nr.4,1997, Prishtinë; ... Kuvajti, Filologji, nr.5,1998; Prishtinë; Poetët palestinezë më të përkthyer në gjuhën shqipe, Filologji, nr.6,1998, Prishtinë.*

¹ Në vitin 1980, me rastin e vizitës së tij në Kosovë, mbajti një ligjëratë në Fakultetin Filozofik për studentët dhe studjuesit e letërsisë arabe.

² *A'da ittihad al-kuttab al-arab*, Dimishk, 1984. Përpiloi Edib Izzet dhe Ismail Amur, bot. i dytë, f.238.

³ *Rilindja*, dt.21.6.1979, Prishtinë.

⁴ Krahajo me shenimin nr. 2, fq.51

Në vitin 1980 poezia e tij *Alivanosja*, të cilën e përktheu nga gjuha frenge Nexhmedin Saliu, me një shenim të shkurtër për autorin, u botua në *Zëri i Rinisë* nr.17-18/1980. Të njëjtin vit, gjithashtu në *Zëri i Rinisë*,⁵ N.Saliu përktheu nga frengjishtja dhe botoi poezinë Ikja. Të gjitha këto poezi të përkthyer, sikurse tërë krijmtarinë poetike të Ahmed S. Ahmedit, i përshkon një frymë lirike e dashurisë e shprehur në frymën moderne

8.2. Makbula Al-Shalak (1921)

Më tepër është e njohur si shkrimtare për fëmijë. Është autore e tre librave me tregime, prej të cilëve dy janë për fëmijë,⁶ dhe autore e një përmbledhje poezishë që doli nga shtypi në vitin 1982, (*Ugnijjatu kalb – kënga e zemrës*), lexuesit tonë i është prezentuar me poezinë *Nëna e therur*. Ky përkthim është botuar në *Rilindje* dt.13.VII.1978.

Poezia e M. Shalakut, *Nëna e therur* të cilën e ka përkthyer në gjuhën shqipe M. Mufaku, është më tepër se një kushtim për t'u mobilizuar në mbrojtjen e çështjes palestineze. Përveç kësaj, ajo me një simbolizëm të cekët thumbon edhe një smundje akute të botës arabe. Poeteshja Shalak e ndien thellë klithmën e nënës therur e cila kërkon ndihmë, por kjo nuk mund t'i përgjigjet pikërisht nga përçarjet ndërarabe, se

*"isha i zënë në ciklonin tim
në grindje me vëllëzërit
ne s'jemi vllëzër
se jetojmë përherë në grindje
dhe nuk bashkohemi fare."*

M. Shalak në gjuhën shqipe më tepër është prezentuar si prozatore.

8.3. Nihad Rida (1927)

Është autor i njëmbëdhjetë përmbledhjeve me poezi dhe i një romani. Ka përkthyer shumë vepra letrare nga gjuha frenge në gjuhën arabe.⁷ Ka marrë pjesë në Seminarin Ndërkombëtarë për gjuhën dhe letërsinë shqiptare.⁸ Nga krijimtaria e tij poetike, në gjuhën shqipe janë përkthyer poezitë: *Mendime të revoltuara dhe Takimi ynë që te hëna*.

Poezitë e N. Ridës, në përkthim të M. Mufakut, për herë të parë u botuan në *Zëri i Rinisë*⁹ me një shenim rasti, por pa të dhëna biografike për

⁵ *Zëri i Rinisë*, nr.32, dt.26.7.1980, fq.15, Prishtinë.

⁶ Shih shenimin nr. 2.

⁷ Po aty.

⁸ *Seminari i kulturës shqiptare për të huaj*, X,1985, Prishtinë.

⁹ *Zëri i Rinisë*, dt 12. 7.1978, fq.13, Prishtinë.

poetin. Të njëjtin vit, poezia e dytë u botua edhe në *Rilindje*¹⁰ me titullin *Takimi ynë në hënë*. Ky titull, vështruar në krahasim me origjinalin është përkthyer më drejt se në rastin e parë. Poezia e Nihad Ridës është simbolike dhe është një poezi në të cilën poeti me mjeshtri të rrallë din të shkri urtinë popullore në mënyrë që në poezi ta shpreh shkaku e humbjes së luftës:

*“ thonë se e kemi humbur luftë
sepse kemi gjuhë të gjatë si gratë:
shpatat tona janë më të gjata se trupat tonë
gjuhët tona janë më të gjata se shpatat tona”!*

8.4. Nizar Kabbani (1923)

Poet i njohur sirian, i cili ka botuar 16 vepra me poezi.¹¹ N. Kabbani, në botën arabe, ka përjetuar edhe famë e respekt por edhe mospërfillje e urrejtje, mu për shkak të shprehjes së tij shumë të lirë në vargjet e tij të lirikës erotike.¹² Përmbledhjen e parë me poezi e botoi në vitin 1944 e cila titullohet *Zeshkania më tha*, dhe me këtë, u bë poeti më i lexuar dhe më i dashuri ndër masat e rinisë arabe. Rininë arabe e përvehtësoi me lirikën e dashurisë ashtu që poezitë e tij shpesh komponoheshin dhe këndoheshin të përcjellura me muzikë.

Mirëpo, në anën tjetër, mu për këtë arsye – për shkak të lirikës erotike – ai shpallet joserioz nga një masë e opinionit arab. Poezia e tij trajtohet si e papranusehme për shkak të vlerave të ulëta morale etj.

Kabbani, diplomat, poet, jurist,¹³ bashkë me të cilin edhe rinia i këndoi poezitë e tij, por edhe i fishkëlloi, lexuesi ynë e nejt në vitin 1977. Ai i prezantohet lexuesit shqiptarë me një poezi që i takon periudhës së dytë të krijimtarisë së tij, periudhës pas vitit 1967, nga ajo periudhë kur edhe Kabbani fillon të shfrytëzojë si burim për poezinë e tij gjendjen reale të popullit të vet – arabëve. Këto tema zëvendësuan temat e mëparshme, ato të dashurisë. Ai i prezantohet lexuesit shqiptarë me poezinë *Një rrugë*, me të cilën ai del si një revolucionarë i denjë për lirinë e Palestinës.

Ai shet edhe unazën e nënës për armë,

*“Të tëra i lash peng
për një pushkë”*

¹⁰ *Rilindja*, dt. 28.9.1979, fq.11, Prishtinë.

¹¹ Shih shenimin nr. 2.

¹² Darko Tanasković, Nizar Kabbani – Neprolazno detinjstvo i sazrevanje ljubavi, “*Zivot*” nr.4, 1979, Sarajevo, pp.379-383.

¹³ Nizar Kabbani, *Kissati ma’ash-shi’r*, Bejrut, 1973.

duke u lutur që ta marrin në luftë

*“në palestinë të më merrni me ju
o njerëz!
dua të jetoj ose të vdes si burrë”.*

Këto vargje të Nizar Kabbanit, në shiqim të parë tingëllojnë fortë, por megjithatë nuk e kanë forcën e vargjeve të poetëve palestinezë. Kabbani bie në provimin e revolucionit kur thotë se gjuha në të cilën mësoni nuk ka vlefte as një gram para një pushke...

Poezia *Një rrugë* u botua në *Rilindje*,¹⁴ përkthyer nga I. Ahmedi, në vitin 1977. Këtu është dhënë edhe shenimi se poezia është marrë nga përmbledhja e titulluar *LA*, e cila është botuar në Bejrut në vitin 1971.

Pas kësaj, Kabbani prezantohet me katër poezi: *Ditari i një kusari, Ditari i një gruaje indiferente, Bukë, hashash dhe hënë dhe Vrasja e imamit*. Këto poezi i ka përkthyer, nga arabishtja, M. Mufaku dhe u botuan në *Fjala*, në vitin 1978. Bashkë me këto poezi përkthyesi boton një artikull me titull *Një poet nga orienti dhe kundër orientit*,¹⁵ i cili i kushtohet krijmtarisë dhe qëndrimit kritik të Kabbanit ndaj qasjes së zgjidhjes së problemeve të grumbulluara me shekuj në shoqërinë arabe.. Prandaj titulli i këtij artikulli, kështu si është, nuk përkon me përmbajtjen e artikullit.

Të katër poezitë e përmendura, ashtu siç ishin këtu, janë përfshirë edhe në librin *Antologji e poezisë së re arabe, Prishtinë, 1979*. Në vazhdim vetëm: *Antologjia...* Me këto poezi poeti thumbon gjendjen ekzistuese në orient, angazhohet për ndryshimin e gjendjes në orient, dëshiron të ketë një orient si duhet të jetë, e jo të përsërisin

*“... si papagaj, predikimet fetare”
dhe të shkojnë
“... te hoxha i lagjës
që të na bëjë magji për fëmij”.*

Ai angazhohet gjithashtu që femra arabe të mos e shikojë bashkëshortin si xhelatin Masrur të “njëmij e një netëve” por të vendosen raporte normale në jetën bashkëshortore e ndërnjerzore. Kabbani i kritikon njerëzit e orientit, kritikon atë shtresë të arabëve të cilët:

¹⁴ *Rilindja*, dt.1.12.1977, f.12, Prishtinë.

¹⁵ *Fjala* nr. 13, dt.15.7.1978, f.11, Prishtinë. Autori i artikullit e quan kundra orientit vetëm për shkak se Kabbani thumbon veset e këqia të orientit, prandaj , mendojmë se nuk mund të thuhet “kundra orientit” ashtu sikundër nuk mund të thuhet p.sh. për Migjenin kundra shqiptarëve, vetëm pse kritikon të metat e popullit a të rrethit të vet.

*"I lusin varret e evliave
për oriz...për fëmij"*

dhe më në fund me shembullin e tij konkret, i vetëdijshëm se "... për veprën time meritoj vrasje". Por që të mos sillet më :

*"si kokërr në tespihët e imamit
pa mend...pa krye...pa këmbë"*

ai merr guximin të pranojë:

*"E vrava imamin në emrin tim
dhe në emrin e miliona deleve,...
Me vrasjen e tij i vrava o zotërinj
Të gjithë ata që nga njëmij vjet
Bëjnë të zeza me fjalë..."¹⁶*

Poezia *Ditari i një kusari* është botuar edhe për së treti herë. Herën e tretë e gjejmë në revistën *Kosovarja*,¹⁷ nga i njëjti përkthyes.

Ismail Ahmedi përktheu poezinë e Nizar Kabbanit, *Ditari i Palestinës*, të cilën poeti ia ka kushtuar Palestinës, e cila u botua në *Zëri i Rinisë* (16.9.1978, f.13.) kurse, Feti Mehdiu përkthen poezinë *Guvernatori dhe zogu*, në të cilën poezi poeti shpreh revoltën kundër organeve të pushtetit sepse ata nuk e lejojnë të qarkullojë lirisht me libra "*nëpër atëdheun arab*", me qëllim që

"t'ua lexoj poezitë e mia masave"

por ata i kërkojnë

*"...pasaportë për zogun (librin)
fjala në atëdheun tim paska nevojë për pasaportë"*

Në këtë mënyrë poeti i zemëruar nga një sjellje e tillë, i hedh e i shkel të tëra poezitë e tij dhe kthehet prap në vendin e vet

*"I hudhur
si gotë e coptuar".*

¹⁶ *Antologjia... fq.41.*

¹⁷ *Kosovarja*, nr.6, dt. 1.6.1982, Prishtinë.

Poezia *Guvernatori dhe zogu* është botuar tri herë. Herën e parë u botua në *Flaka e vëllazërimit*,¹⁸ e pastaj në *Bota e Re*¹⁹, brenda vitit 1980, kurse në vitin 1981 u botua edhe në revistën *Koha*, nr.6/1981.

8.5. Rijad Salih Al-Husejn (1954 -1982)

Megjithëse ky poet vdiq në moshë të re, jetoi vetëm 28 vjet – sa edhe Migjeni, ai ka lënë tri përmbledhje me poezi në gjuhën arabe.²⁰ M.Mufaku nga poezitë e tij ka përkthyer në gjuhën shqipe poezinë *Marsejeza e kohës neutronike*, e cila është botuar në *Fjala* nr. 7/1978.

8.6. Rexha Arnaut (1946)

Poetsha e re me prejardhje shqiptare është e njohur edhe si përkthyes nga gjuha frenge në gjuhën arabe. Ka botuar dy përmbledhje me poezi në gjuhën arabe si edhe një libër me poezi të përkthyer nga gjuha vietnameze.

Në gjuhën shqipe, M. Mufaku i ka përkthyer katër poezi të saj dhe i botoi, herën e parë, në *Zëri i Rinisë* nr.23, dt.3.6.1978. Të njëjtat poezi janë përfshirë edhe në librin **Prapa natës, Prishtinë**, me 1980. Në vazhdim vetëm Prapa natës... Poezitë e R. Arnautit që janë përkthyer shqip janë: *Një shenj, Lindje, Deti dhe Valët*, të cilat ishin botuar më parë në *Zëri i Rinisë*, si edhe ato : *Shpresë, Prekje, Stuhi dhe Lumi*, të cilat botohen në këtë libër për herë të parë.

Këto poezi japin një pasqyrë për preokupimet e poeteshës e cila simbolikisht shëron mijëra plagë:

“çdo valë
po thërret tjetrën valë
të pastrojë mijëra plagë
të mjekojë sytë
e mbyllur
me tampon harrese”

ose raporti i lumit të vogël me detin e madh, i cili e din se derdhet në det, por

“s’ka rëndësi!
Lumi i vogël po zbulon botën në udhëtimin e tij...
Pastaj le ta përbijë qetësia e detit.
S’ka rëndësi!”

¹⁸ *Flaka...* dt.9.3.1980, Shkup.

¹⁹ *Bota e Re*, nr.8, dt.15.4.1980, f.15, Prishtinë.

²⁰ Shih shënimin nr. 2.

8.7. Sulejman Al-Isa(1921)

Në gjuhën shqipe është përkthyer poezia e tij *Nesër* e cila është prezentuar qysh në vitin 1962. Nga kjo poezi e tij shihet se S. Isa është optimist. Ai ka besim të paluhateshëm për ardhmëri më ti mirë, prandaj

"çdo nesër duhet me pru ngadhnjim"

sepse

*"e nesërmja jonë në shkëlqimin e vet
është ma e fortë se vdekja".*

Këtë poezi të Sulejma al-Isës e ka përkthyer nga serbokroatishtja Adem Gajtani, nga *Knjizevne Novine*, dhe e botoi në *Flaka e Vëllazërimit* dt.192.1962,f.7. Fakti se kjo poezi është botuar në gjuhën serbokroate me 26 janar, kurse në gjuhën shqipe me 19 shkurt të njëjtit vit flet se në opinionin shqiptarë mbretëronte një etje dhe interesim i madh për t'u njohur me poezinë arabe.

8.8. Shavki Bagdadi(1928)

Shavki Bagdadi është autor i njëmbëdhjetë veprave, prej të cilave shtatë janë përmbledhje poezishë kurse të tjerat janë tregime për të rritur dhe për fëmij.²¹ Tek ne është përkthyer poezia e tij *Të shkruajsh poezi* që u botua në *Flaka*.... 3.4.1977, të cilën e ka përkthyer Neki Fejza. Përkthyesi afron edhe një shënim të shkurtër për autorin, por nuk ka shënuar se nga cila gjuhë e ka përkthyer. Sipas mendimit tonë ky është përkthim nga serbokroatishtja

8.9. Abdulkadr Arnaut (1936-1993)

Abdulkader Arnauti është i njohur më tepër si piktor, jo vetëm në Siri por edhe jashtë Sirisë, si në botën arabe ashtu edhe më gjërë me ekspozitat e tij të pavarura. Shkruan edhe poezi. Ka botuar përmbledhjen *Rimad ala erdin barida*. Ka prejardhje nga Dobërluka e Vishterrisë dhe këto lidhje të tij me Kosovën shprehen edhe në poezinë e tij, por në gjuhën arabe.

Në gjuhën shqipe janë përkthyer tetë poezi të tij. Për herë të parë poezia e tij *Gozhdë e ndryshkët* u botua, në përkthim të M.Mufakut, në *Zëri i Rinisë* nr.32 të vitit 1977. Në vitin vijues, me 1978, në përkthim të F. Mehdiut janë botuar poezitë *Varri im*, e cila herën e parë u botua në *Rilindje*,²² dhe *Shpërngulja*, e cila bashkë me poezinë *Varri im* janë botuar në *Flaka*... dt.16.2.1978, me një shënim të shkurtër për jetën e autorit. Më vonë, në përkthim të M. Mufakut u botuan poezitë *Zoti dhe Ademi*, *Fat Fatimeje*, *Dashuri sot dhe Vinjetë*, në *Rilindje* të datës 4.1.1979.

²¹ Shih shënimin nr. 2.

²² *Rilindja*, dt. 16.2.1978, f.11, Prishtinë.

Ndërkaq në librin *Prapa natës*,²³ Andulkadr Arnauti është përfaqësuar me gjashtë poezi prej të cilave vetëm poezia *Arkivoli* botohet për herë të parë, sepse pesë të tjerat lexuesi ynë i ka lexuar edhe në faqet e shtypit të përditshëm.

Në poezinë e këtij poeti idhtësia e së kaluarës që kanë përjetuar parardhësi e tij, do të gjejë shprehje dhe do të shpërthejë sidomos në poezinë *Shpërngulja*, ku thotë:

*“Në arkën e parë...
pata lënë, në te...para se të shpërngulem
një grusht mburrje... një pjesë të vehtes
E mbylla arkën.. dhe shkova”*

Arnautin e preokupojnë edhe probleme të jetës e cila është tepër dinamike kur njeriu nuk ka kohë të shohë as edhe ku shkel dhe kënd po e shtyp. Sëkëndejmë edhe dashuria është shndërruar në numra:

*“sot vetëm digitroni
mund ta masë dashurinë”*

8.10. Ajshe Arnaut (1946)

Është shkrimtare e talentuar nga Siria. Në vitin 1960 fitoi shpërblimin e parë në një konkurs letrar për tregim në Liban. Pasi që nuk kishte më shumë se katërmëdhjet vjet kritika letrare e quajti Sagan e Sirisë. Ajshe Arnauti është prezentuar në Antologjinë e poeteshave arabe që u botua në Nju Jork, kurse lexuesi ynë, me poezinë e saj, njihet në vitin 1977. Atë vit, M. Mufaku përktheu poezitë e saj: *Do të pres dhe Dyndja*, dhe i botoi në *Zëri i rinisë*²⁴. Në librin *Prapa natës*, Ajsheja prezentohet me gjashtë poezi të cilat botohen për herë të parë, në këtë libër, si edhe me poezinë *Dyndja* që ishte botuar edhe më parë në *Zëri...* nr.32/1977.

Poezitë e përkthyer që janë botuar në këtë vëllim janë : *Agimi i fëmijërisë, Pa titull, çdo gjë është e rreme, I ndëshkuar, e i dhunuar, Pjellë e ndryshkut dhe Ngaher* kur... Këto gjashtë poezi, të njëjtin vit u botuan edhe në revistën *Fjala* nr.7/1980. Poezitë janë nxjerr nga libri *Prapa natës* dhe janë përcjellë me një shenim për autoren.

Poeteshat i ka lënë hapësirë të mjaftueshme edhe çështjes së shpërnguljes së familjes së vet, si rrjedhojë e një lufte, kur

²³ Muhamed Mufaku, *Prapa Natës*, poezi e shqiptarëve të Sirisë, Prishtinë, 1980. Botoi Rilindja, fq.76. Mëtej vetëm *Prapa Natës*.

²⁴ *Zëri i Rinisë*, nr. 32, dt. 8.9.1977, Prishtinë.

*"shpërtheu një luftë në qiell
midis pëllumbave të zezë të huaj
dhe pëllumbave tonë të bardhë..."*

dhe me atë rast i vdiq gjyshja dhe e lanë në rrugë. Prandaj ajo që atëherë bartë në shpirtë një përmallim të zjarrt,

*Në gjakun tim
Kaherë ka ngelur si zjarr
Zjarri i dashurisë
Zjarri i mallit
Për vendin tim".*

Në poezitë e saj shfaq edhe preokupimin e saj me problemin e krimeve gjithënjëzore në tërë botën, të cilat si një lojë shahu kanë filluar kaherë – qysh me fillimin e gjinisë njerëzore në tokë. Për ta shprehur këtë ajo motivin historik që e ka burimin tek bijt e Ademit, e shkrinë në talentin poetik dhe me imagjinatë të vrullshme do të përfundojë:

*"Dhe deri më tani
o miq të mi të vdekur e të gjallë
që nga koha e Kabilit dhe Habilit²⁵
nuk u krye loja as tani".*

8.11. Barakat Latif Arnaut (1935)

Barakat Latif Arnauti është poeti shqiptarë arabofon, i cili është përkthyer më së shumti në gjuhën shqipe. Ai është një puntorë hekurudhe, prandaj edhe përmbledhjen e vet me poezi e ka titulluar *Këngët e llokomotivistit*²⁶. Kjo përmbledhje doli nga shtypi në vitin 1979 në Damask, dhe, të njëjtin vit u përkthye dhe u botua në gjuhën shqipe poezia *Këngët e llokomotivistit* dhe u botua në *Rilindje* dt.3.8.1979. Këtë poezi e përktheu nga gjuha arabe Abdulatif Arnauti, gjithashtu një shqiptarë nga Siria, i cili edhe vetë shkruan poezi në të dyja gjuhët: arabisht dhe shqip.

Nga i njëjti përkthyes kemi edhe dy poezi tjera të Barakatit : *Poema e mërgimtarëve dhe Vargje pa titull*. E para u botua në *Bota e Re* ²⁷ kurse e

²⁵ Këta dy janë simbol i krimit dhe i së keqes në botë. Janë dy bijt e Ademit a.s. prej të cilëve Kabili bëri krimin e parë në botë, vrau vëllaun e vet Habilin.

²⁶ Barakat Latif Arnaut, Anashid saiku-l-kitar, Dimishk, 1979, f.90. Botoi Vizaretu-th-the kafeti va-l-irshadu-l-kavmijj.

²⁷ *Bota e Re*, nr. 3-4, dt.15.2.1980, f. 20, Prishtinë.

dyta në Rilindje.²⁸ Këto dy poezi nuk janë në përmbledhjen e përmendur të Barakatit.

Në vitin 1980 Muhamed Mufaku përktheu dhe përgatiti për shtyp librin **Prapa natës**, në të cilin libër B. Arnauti përfaqësohet me nëntë poezi: *S'ka frikë, Gjethet e limonit, Tymi dëshmon njerinë, Makinat, Një parajs prapa natës, Shpresë, Gjykimet, Shokut udhëtarë*, I, II, III dhe *Ah, tash e pranoj varfërinë tënde*. Të përmendim se pesë nga këto poezi, një vit më vonë, me 1981, u botuan edhe në *Flaka e Vëllazërimit*.²⁹

Poezinë e brakat Latif Arnautit e përshkon fryma e patriotizmit të dyfishtë: malli ndaj atëdhëut prej nga u shpërngulën të parët e tij, dhe, dashuria ndaj vendit dhe njeriut të rrethit ku jeton. Ky këndon drejtpërdrejt për njeriun punëtorë, për gjendjen e tij, i këndon , njeriut i cili është:

"duke jetuar prej thonjëve"

dhe pret

"gjykimin si lule në shkrtëtirë" (PN, f.42)³⁰

Poeti e don njëlloj vendlindjen e të parëve dhe i vjen shumë keq që:

*"Kur na konfiskuan atëdheun
pse s'e përdora grushtin tim
që e kisha përherë letërnjoftim"* (P.N. f.41)

Gjatë përkthimit, sidomos të poezisë *Shokut udhëtar*, e cila ka dalë me 26 vargje më pak, është bërë, sipas mendimit tim, një shkurtim i panevojshëm. Megjithatë porosia të cilën poeti ua drejton lexuesve mund të nxirret edhe nga këto vargje, e ajo është, vetëdija e lartë për durim dhe qëndresë, madje edhe te fëmijët, kur ata

*"I luajnë dhëmbët me buk thatë
kaloi një vit pa bukë
te fqiu ynë..."*

i cili lutet

*"baba,
shkruaje një poezi të gjatë"*

²⁸ Rilindja, dt.31.1.1980, f.11, Prishtinë.

²⁹ Flaka... dt.15.2.1981, Shkup.

³⁰ shkurtica për librin *Prapa Natës*.

*të gjatë
sa varfëria jonë
aq sa të mund të blejmë
rrobat e rinisë për shkollë"*

dhe kjo shpresë po rritet

"në grushtin e fëmijëve të mi".

8.12. Bandar Abdu-l-hamid (1947)

Ka botuar gjashtë përmbledhje me poezi në gjuhën arabe,³¹ kurse në gjuhën shqipe është prezentuar me poezinë *Dashnori*. Këtë poezi e ka përkthyer nga origjinali, Muhamed Mufaku të cilën e ka marrë nga përmbledhja e B. Abdu-l-hamidit *I'lanat al-mavt va-l-hur-rijja* (Shpalljet e vdekjes dhe të lirisë) dhe e botoi në *Bota e Re*,³² Më këtë rast, përkthyesi, ka dhënë edhe një shenim të shkurtër për autorin, që gjithsesi e ndihmon lexuesin shqiptarë sepse i afron edhe disa tituj të veprave të tij.

8.13. Halil Merdun Beg (1898-1959)

Lexuesi ynë, këtë poet, e njeh përmes poezisë *Melodia e kumrisë*, të cilën e përktheu nga arabishtja Hamdi Thaçi dhe është botuar në *Rilindja* dt.6.9.1973, fq.10. H. Merdun Beg është me origjinë shqiptare, por nuk është përfshirë në librin Prapa natës.

8.14. Hatixhe Arnaut (1934)

Është autore e dy përmbledhjeve me poezi. Shkruan edhe prozë – tregime, por vetëm në gjuhën arabe. Para lexuesit shqiptarë është prezentuar, për herë të parë, me poezinë *Lotët*, e cila u botua në *Zëri i rinisë* nr.32/1977. Në vitin 1979 janë botuar edhe dy poezi të sajë në *Fjala*.³³ *Jam vajzë pa atëdhe dhe Flamuri*. Këto poezi i përshkon një mallë i thellë dhe i pashuar për atëdheun – vendlindjen e të parëve, ku poetesha dëshiron, të paktën afër atdheut, të ketë një fole

"që të qetësohem nga dhembjet e mia" (P.N. f.34.)

atje ku flamuri

*"... valon mbi dheun e të parëve...
dhe sado që vargjet:*

³¹ Shih shënimin nr. 2.

³² Bota e Re, dt.15.1.1981, Prishtinë.

³³ *Fjala*, dt.1.9.1970, Prishtinë.

*"Të erdhi koha e krenarisë
valo në qetësi
ngritu sa më lart mbi dhe
mburru me krenari
se shpata do të shpëtojë!"*

tingëllojnë si një shprehje declarative, ata prapëseprapë përmbajnë në vehte diçka që vlon në ndjenjat e poeteshës për të shfaqur respektin dhe kujdersin ndaj flamurit komëtarë të saj.

Të dyja këto poezi i ka përkthyer nga origjinali Muhasmed Mufaku dhe janë përfshirë në librin Prapa Natës të botuar në prishtinë , në vitin 1980.

8.15. Mustafa Huluki (1850 – 1915)

Huluki është një figurë ushtarake, përkthyes dhe poet, veprimtaria e të cilit ka ngel në faqet e shtypit të Sirisë dhe Libanit. Rrjedh nga shqiptarët e Kavallës,³⁴ të cilët janë shpërngulur dhe janë vendosur në Siri. Në poezinë e tij vërehet përvoja jetësore e shprehur në poezi me theks refleksiv dhe romantik,

*"nëse s'ka kurrfar të mirë në vetmi
mjafton të jeshë larg njerëzve të ligj" (PN,f.17)*

ose

*"Në mes meje e teje
ka një ngjashmëri:
një trup shkrihet
dhe një zemër digjet"*

Në gjuhën shqipe është prezentuar në librin Prapa natës, me 1980, me dy poezi: Qiriut dhe vetmi., të cilat i ka përkthyer nga origjinali Muhamed Mufaku.

9.0. Poezi arabe nga Sudani

9.1. A. Halavani

Poeti sudanez Halavani, në gjuhën shqipe, është prezentuar me poezinë *Odë miqësisë dhe unitetit*, në të cilën ven në spikamë rëndësinë që ka bashkëpunimi ndërmjet popujve të botës. Poeti angazhohet që në botë të mbretërojë miqësia midis popujve ngase kjo është arma më e fortë kundër armikut:

³⁴ Shih shënimin nr. 2.

*"Miqësia në mes të popujve të botës
është si një zjarr skëterre për armikun
Miqësia në mes të popujve
Është një çels i vërtetë për fitoren."*

Poeti thekson se armiku nga asgjë nuk frikësohet sa nga bashkimi i popujve të ndërgjegjshëm, prandaj ai përfundon:

*"Gjith bota
u përket popujve,
popujve që luftojnë ,
për lirinë, drejtësinë:
Që luftojnë për çlirimin e tyre".*

Halavani është i bindur thellësisht se vetëm drejtësia ngadhnjen. Këtë poezi e ka përkthyer I. Çaçi dhe është botuar në Mësuesi nr.43/1973.

9.2. Muhammed Al-Fituri(1930)

Fituri është poet dhe dramaturg, i cili duke filluar nga viti 1955, kur e botoi përmbledhjen e parë *Agani Afrika* (Këngët e Afrikës), ka botuar njëmbëdhjetë vepra letrare. Nga këto dy janë drama në poezi.³⁵ Lexuesi shqiptarë M. Fiturin e njeh prej vitit 1957 përmes poezisë së tij Unë jam i zi, të cilën e ka përkthyer Mark Gurakuqi dhe u botua në revistën letrare Nëntori.³⁶

Pas kësaj periudhe, në vitin 1979, prezentohet edhe në Antologjia e ...³⁷ Me dy poezi: Vdiq nesër dhe Hidhërimet e qytetit të zi, të cilat i ka përkthyer, nga origjinali Muhammed Mufaku. Fituri e quan vehten poet i dhembjeve. Ai shpreh dhembjen e tërë Afrikës së zezë, për të cilën angazhohet që ajo të ketë tretman si tërë vendet tjera, pavarësisht çfarë ngjyre kanë afrikanët. Ai është luftëtarë i denjë për të drejtat e liritë njerëzore të zezakut të Afrikës. Poezia e tij është shpresëdhënëse dhe plot besim e kurajo, se:

*"një ditë do të piqet për mua fryti i korrjes
po edhe qielli, toka dhe rrjedha e lumit
dhe do të marrë fund uria e dheut
si dhe e njerëzve!" (Antologjia... f.89)*

³⁵ Rade Božović, Čovek procenjuje čoveka a ne bog. *Život*, nr. 4, 1979, Sarajevo, pp 392-395. Shih edhe shënimin nr.2, f. 566.

³⁶ Nëntori, nr.5,1957, Tiranë.

³⁷ Shih: Antologjia e poezisë re arabe e M. Mufakut...

Në vitin 1965, nga një përkthyes i panjohur e këmi të përkthyer poezinë e Fiturit Vërshimi i zi, e cila është botuar në gazetën Flaka...³⁸ Kjo është një poezi ku shprehet mllefi dhe revolta e poetit kundër dallimeve racore dhe kundër robërimit të zezakëve nga njerëzit e racës së bardhë.

Fituri është bashkë me masat popullore të Afrikës dh e ai

*“skalit në murin e kohës
këngët e Afrikës të mbytura në gjak”.*

9.3. Taxh As-sirr Al-Hasan (1930)

Poet modern i cili në Sudan radhitet në avangardën e poezisë së re. Lexuesi ynë e njeh prej vitit 1961, me poezinë Lulja në shtegun e kujtimeve. Poezia është përkthyer nga dy përkthyes të ndryshëm. Sëpari e përktheu Din Mehmeti, sipas të gjitha gjasave nga serbokroatishtja, dhe e botoi në Rilindja dt.3.9.1961. Po këtë vit, e njejta poezi botohet edhe në revistën Jeta e Re nr.5/1961, në përkthim të Enver Gjerçekut.³⁹

Kur i krahasojmë këto dy përkthime e shohim se përkthimi i Din Mehmetit është më i plotë, gjë që shprehet edhe në vargjet e kësaj poezie. Të dy përkthyesit e kanë për bazë botimin në serbokroatisht nga Književne Novine të datës 25.8.1961.

T.al-Hasan është prezantuar, në gjuhën shqipe, edhe në vitin 1966 me poezinë *Athara* e cila botohet në gazetën Drita⁴⁰. Bashkë me këtë poezi të Hasanit, botohet edhe një poezi nga një poet sudanez Hair, A.M. *Një bij, njëmij ngrihen*, por për këto nuk ka shenime më të hollësishme.

³⁸ *Flaka...* dt.9.5.1965, f.6, Shkup.

³⁹ Poezitë e botuara në *Jeta e Re*, nr. 5, 1961, i përgatiti për shtyp Enver Gjerçeku, mirëpo , me qe E. Gjerçeku nuk shenon se kush është përkthyes, në Bibliografinë e orientalistikës Jugosllave nga Bisera Nurudinoviq trajtohet si përkthyes i këtyre poezive. Pasi që këto poezi janë botuar më parë në gazetatat: Flaka... Rilindja, dhe atje është dhënë emri i përkthyesit, mendojmë se këtu E.Gjerçeku ka bërë përgatitjen për botim në këtë revistë. Shih: *Letërsia arabe në Jeta e Re, 1949-1989*, Studime Orientale, nr.1, 2001 , Prishtinë.

⁴⁰ *Drita*, dt.24.4.1966, Tiranë.

Dr. Feti Mehdiu

Translations of the Arabian poetry into Albanian language – Arabic poetry from Syria and Sudan

Summary

This is a chapter from the dissertation of the Ph.D. entitled “Translations of Arabic literature into Albanian language”- 1922-1982, defended in 1990 at the University of Prishtina. Some parts have already been published in the past⁴¹ and here we will present the chapter containing the Arabic poetry from Syria and Sudan which are translated into Albanian.

In this study we see that the Syrian and Sudan poets have presented their poetry to the Albanian readers in the 60's of the 20th century. This paper is illustrated with some translated lines into Albanian language, enabling scholars to come up with their own judgement with regard to the reasons that lead the Albanian translator to translate these poems.

⁴¹ See in: *Gjurmime albanologjike*, nr. 27/1997, seria e shkencave filologjike, Prishtinë; *Filologji*, nr. 4/1997, Prishtinë; *Filologji*, nr. 5/1998, Prishtinë; *Filologji*, nr. 6/1998, Prishtinë.

